



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES , KUJDESIT DHE PËRFSHIRJES SOCIALE

SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

Nr. 3748 prot.

Vau Dejës, me 15 / 06 /2021

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim

Z.Mark Bisha

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK – VAU DEJËS

I nderuar zoti Kryetar,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projektvendimin dhe materialin shoqërues për:

“Për ngritjen e komisionit të strehimit dhe miratimin e rregullores së funksionimit të komisionit të strehimit”

Me respekt

**KRYETARI
MARK BABANI**



Miratoi:

Çuka Babani : Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social

Konceptoi:

Kristinë Shtatri : Përgjegjës i Sektorit të Asistencës Ligjore, Kontratave dhe Cështjeve Gjyësore

Datë: _____

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacionit shoqërues: _____

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES , KUJDESIT DHE PËRFSHIRJES SOCIALE

SEKTORI I SHËRBIMIT SOCIAL

Adresa, Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës nr. Tel: Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail e-mail: info@vaudejes.gov.al

PROJEKT VENDIM

Nr. 08 datë 15.06, 2021

“Për miratimin e ngritjes së komisionit të strehimit dhe rregulloren e funksionimit të Komisionit të Strehimit”

Në mbështetje të nenit 24, pika 2, neni 54 gërma “k” e Ligjit nr 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar ; Ligji nr 22/2018 “Për strehimin social”, neni 2 pika 51; VKM nr 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, me propozimin e Sektorit të Shërbimit Social, Kryetar i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak të :

VENDOSI

1. Miratimin e ngritjes së komisionit të strehimit, me përbërje si më poshtë:
 - Çuka Babani- Kryetar , (Psikologe) Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social
 - Kristinë Shtatri- Zv/ Kryetar, (Jurist) Përgjegjëse e Sektorit të Asistencës Ligjore, Kontratave dhe çështjeve gjyqësore.
 - Renato Doda – Anëtar,(Ekonomist) Specialist Sektori i Buxhetit dhe Financës
 - Gerralda Gogaj-Anëtar, (Inxhinier Ndertimi) Specialist Sektori i Investimeve
 - Ermira Mlloja- Anëtar , (Psikologe) Specialiste Sektori i Shërbimit Social
 - Atila Uligaj- Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës “Gruaja te Gruaja” Shkodër
 - Kujtime Nurja-Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës Qendra e Gruas “ Hapat e Lehtë”
2. Miratimin e rregullores së funksionimit të komisionit të strehimit , bashkëngjitur.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6 të Ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”)

KRYETAR
MARK BABANI

Konceptoi
Përgjegjës/Pergj. Sek. Asistences Ligjore
Kristinë Shtatri
Miratoi:
Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social
Çuka Babani





BASHKIA VAU DEJËS

RREGULLORE

“PËR PËRBËRJËN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË STREHIMIT”

Datë _____ 2021

NENI 1

QËLLIMI

Qëllimi i kësaj rregullore është krijimi i një kuadri rregullator për mënyrën e përbërjes dhe funksionimit të Komisionit të Strehimit, për një veprimtari më eficiente dhe transparente ndaj të tretëve, të përcaktuar nga aktet ligjore dhe nënligjore të Republikës së Shqipërisë. Ky Komision në përputhje me normat juridike, duhet që, sa herë në Bashkinë Vau Dejës ka në zbatim një program social strehimi, të shqyrtojë kërkesat dhe dokumentacionin për të bërë të mundur, vlerësimin teknik sipas sistemit të pikëzimit të miratuar në Këshillin Bashkiak, të listës emërore të personave aplikues, me qëllim sigurimin e transparencës dhe efijencës së tij si organ kolegjal përballë aplikuesve.

NENI 2

BAZA LIGJORE

Kjo rregullore hartohet bazuar në:

- Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 22/2018 “ Për strehimin social”
- LigjinNr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.”
- VKM Nr. 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”.

NENI 3

PARIMET MBI TË CILAT FUNKSIONON KOMISIONI

Parimi i Ligjshmërisë: Komisioni i Strehimit ushtron funksionet në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

Parimi i Transperencës: Komisioni i Strehimit ushtron veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me Sektorin e Shërbimit Social , e cila pasi ka marrë në dorëzim listën e vlerësimit nga ana e Komisionit ka detyrimin të njoftojë brenda 10 ditëve aplikuesit.

Parimi i Drejtësisë dhe Paanësisë: Në ushtrimin e funksioneve të tij, Komisioni i Strehimit trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha dosjet e aplikantëve.

Parimi i Objektivitetit: Gjatë ushtrimit të proçedurës administrative, Komisioni i Strehimit ka detyrimin të marrë në konsideratë dhe t’i japi rëndësinë e duhur të gjithë dokumentacionit të

dorëzuar, si dhe të bëjë verifikimin e kushteve dhe të dhënave që lidhen me këtë procedurë administrative.

Parimi i Përgjegjesisë: Anëtarët e Komisionit të Strehimit, kur kryejnë një procedurë administrative, ka detyrimin ligjor që për palët që janë në situata të njëjta objektive, t'i trajtojnë në mënyrë të barabartë. Komisioni ka detyrimin që në zbatim të dispozitave ligjore të shmangë çdo diskriminim që ka të bëjë me gjinin, racën, ngjyrën, etninë, orientimin seksual, bindjet politike apo fetare, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, etj.,

NENI 4

PËRBËRJA KOMISIONIT

Komisioni i Strehimit do të përbehet nga 7 (shtatë) anëtarë me të drejta të plota, ku njëri prej tyre do të jetë në cilësinë e Kryetarit, i dyti Zv/Kryetari dhe të tjerët në cilësinë e anëtarit.

Në përbërje të tij duhet të ketë, anëtarë me profesion ekonomist, jurist, arkitek/inxhinier ndërtimi, dhe anëtarë përfaqësues të organizatave jofitimprurëse me aktivitet në juridiksionin e Bashkisë Vau Dejës.

Komisioni përbëhet nga:

- Çuka Babani- Kryetar , (Psikolog) Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimit Social
- Kristinë Shtatri- Zv/ Kryetar, (Jurist) Përgjegjëse e Sektorit të Asistencës Ligjore, Kontratave dhe çështjeve gjyqësore.
- Renato Doda – Anëtar,(Ekonomist) Specialist Sektori i Buxhetit dhe Financës
- Gerralda Gogaj-Anëtar, (Inxhinier Ndertimi) Specialist Sektori i Investimeve
- Atila Uligaj- Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës “Gruaja te Gruaja” Shkodër
- Kujtime Nurja-Anëtar, Përfaqësuese e Organizatës Qendra e Gruas “ Hapat e Lehtë”

NENI 5

ORGANIZIMI

1.Komisioni i Strehimit kryesohet nga Kryetari dhe në mungesë të tij nga Zëvendëskryetari.

2. Njëri nga anëtarët e Komisionit të Strehimit ka për detyrë të administrojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm të procedurës së ndjekur nga Komisioni i Strehimit.

3. Komisioni i Strehimit mblidhet në përputhje me afatet e caktuara në VKM nr. Nr. 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”.

4. Njoftimi i anëtarëve të Komisionit të Strehimit duhet të bëhet 5 ditë para datës së zhvillimit të mbledhjeve.

5. Anëtarët e Komisionit të Strehimit njoftohen nga personi i autorizuar nga Kryetari i Komisionit të Strehimit.

6. Komisioni merr vendimet kur në mbledhje marrin pjesë (50+1%) e anëtarëve.

NENI 6

FUNKSIONIMI

1. Komisioni i Strehimit propozon sistemin e pikëzimit, apo kërkon ndryshimin e tij sipas dispozitave ligjore në fuqi. Sistemi i pikëzimit dërgohet më pas për miratim në Këshillin Bashkiak.

2. Statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat, në momentin e aplikimit, plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 13 të ligjit nr.22/2018 “ Për strehimin social”, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për strehim në njësinë vendore, ku ata janë regjistruar.

3. Sektori i Shërbimit Social, Specialisti i Strehimit në Bashkinë Vau Dejës bën seleksionimin e formularëve të vlefshëm dhe i regjistron në një sistem elektronik, i cili i jep mundësi filtrit të të dhënave, si më poshtë vijon:

a) Identitetin, emrin, atësinë, mbiemrin;

b) Numrin e kërkesës;

c) Datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;

ç) Objektivin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e strehimit social;

d) Numrin dhe emërtimin e dokumenteve që i bashkëngjiten kërkesës;

dh) Adresën e kërkuarit;

e) Përbërjen familjare në momentin e aplikimit;

ë) Statusin e punësimit;

f) Kushtin social

g) Kushtin e strehimit

gj) Kushtin familjar

h) Kushtin ekonomik

4. Komisioni Strehimit në çdo rast në Bashkinë Vau Dejës aplikohet një program social për stehimin, në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.22/2018 “ Për stehimin social”, si dhe në pikën 7 të VKM Nr. 384, datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore:, merr në shqyrtim të gjithë aplikimet dhe dokumentacionin e plotë të aplikuesve që kanë aplikuar panë Bashkisë së Vau Dejës.

5. Komisioni i Strehimit, brenda 10 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të regjistrit të formularëve të aplikimit dhe formulareve të aplikimit, vlerëson me pikë secilin aplikim, sipas sistemit të pikëzimit të programeve përkatës të miratuar nga Këshilli i Bashkisë.

6. Në përfundim të procedurës së vlerësimit me pikë, harton listën e familjeve sipas vlerësimit në rendin zbritës. Proçesverbali mbi proçedimit si dhe listën e aplikuesve me vlerësimet përkatëse, pasi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit, paraqiten me protokoll pranë Sektorit Social.

7. Sektori i Shërbimit Social, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të listës së vlerësuar nga Komisioni i Strehimit në bashkëpunim me koordinatoren për të drejtën e informimit publik, njofton familjet dhe individët për vlerësimin e kryer nga Komisioni i Strehimit, duke e publikuar atë në faqen zyrtare ëeb të Bashkisë Vau Dejës dhe duke e afishuar në të gjithë Zyrat me Një Ndalesë të të gjitha Njësive Administrative të Bashkisë Vau Dejës.

8. Familjet dhe individët, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit, kanë të drejtën e ankimit pranë Bashkisë Vau Dejës duke paraqitur me shkrim ankesën pranë Zyrave me Një Ndalesë. Familjet mund ta refuzojnë formën e strehimit dhe të mbeten përsëri në listën e pritjes, vetëm kur nuk u janë plotësuar kushtet e strehimit, sipas normave në fuqi. Në rast të kundërt, u hiqet e drejta për aplikim dhe u fshihet emri nga lista e pritjes.

9. Kryetari i Bashkisë Vau Dejës/ ose personi i autorizuar prej tij, brenda 5 (pesë) ditëve nga afati 30 (tridhjetë) ditore kalendarike për ankimin, trajton ankesat e paraqitura. Kryetari i Bashkisë pas vlerësimit të ankesave i drejtohet me shkresë për rishqyrtim Komisionit të Strehimit, i cili brenda 5 (pesë) ditëve merr në rishqyrtim ankesat e përcjella nga Kryetari Bashkisë, dhe pasi bën vlerësimin përkatës, harton listën përfundimtare të vlerësimit me një pikë në rendin zbritës të familjeve dhe individëve aplikues. Proçesverbalin mbi menyrën e proçedimit si dhe listat e aplikuesve me vlersimet përfundimtare përkatëse, pasi nënshkruhet nga të gjithë anatarët e Komisionit, paraqitet me protokoll pranë Sektorit të Shërbimit Social.

10. Sektori i Shërbimit Social brenda datës nga data e marrjes të listës së vlerësuar nga Komisioni i Strehimit, njofton familjet dhe individët për vlerësimin përfundimtar të kryer nga Komisioni i Strehimit, duke e publikuar atë ne faqen zyrtare ëeb të Bashkisë Vau Dejës dhe duke e afishuar në të gjitha Njësitë Administrative të Bashkisë Vau Dejës.

11. Familjet përfituese, pas marrjes së njoftimit, dorëzojnë në zyrat përkatëse dokumentacionin që përban deklaratimet e bëra në fazën e parë të aplikimit, sipas pikës 5 të VKM Nr. 384, datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet qeverisjes vendore”.

Lista e dokumentacionit të nevojshëm:

Për të dhënat personale:

- Çertifikata e lindjes së aplikantit dhe certifikatën e gjendjes familjare (shkarkohet në E-Albania);
- Vërtetim për vendbanimin në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku kërkohet strehimi social, për familjet që kanë levizur nga zona të tjera të vendit.

Për vërtetimin e kushteve të strehimit:

- Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për pronat që disponohen në emër të secilit anëtar të familjes (shkarkohet në E-Albania);
- Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për sipërfaqen e pronës, që zotëron familja apo ndonjë anëtar i saj, kur banesa është me sipërfaqe nën normat në fuqi të strehimit (shkarkohet në E-Albania);
- Vërtetimin nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të vendit të origjinës se nuk figurojnë e rregjistruar asnjë pronë, e cila mund të përdoret për strehim, për çdo anëtar të familjes, që kanë ndryshuar vendbanim për efekt punësimi;
- Vërtetimin që banesa është në proces legalizimi, në mungesë të certifikatës së pronësisë.
- Akt verifikimi nga Bashkia për:
- Banesat në rrezik shembjeje.
- Akt verifikimi nga struktura përgjegjëse e bashkisë për familjet rome/egjiptjane që banojnë në banesa individuale ose struktura, që nuk klasifikohen si banesë;

Për vërtetimin e kushteve familjare:

- Çertifikatë familjare (shkarkohet në E-Albania);
- Vendimin e gjykatës, që i lë në ngarkim fëmijën ose fëmijët për çiftet e divorcuara, shoqëruar me vërtetimin nga zyra e përmbarrimit për masën e pensionit që përfitojnë për fëmijët;

Për vërtetimin e kushteve sociale:

- Vërtetimin e Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Aftësisë së Kufizuar, për individë me aftësi të kufizuara,
- Vërtetimin përkatës nga institucioni ku ka qenë i strehuar dhe librezën e jetimit, dhënë nga institucioni shtetëror i autorizuar, për individët me statusin e jetimit;
- Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për personat që kanë statusin “emigrant”, “punëtor emigrant” dhe “azilkërkues”:

Emigrant dhe punëtor emigrant

– Vërtetim nga sportelet e migracionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Cështjeve sociale.

– Vërtetim nga Zyra e shërbimit Kombëtar ose Vërtetim i marrë pranës Zyrës së Punës Azilkërkues:

- Vërtetim nga Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët në Ministrinë e Brendshme.

- Dokumentin e lëshuar nga institucionet përkatëse shtetërore për familjet e punonjësve të rënë në detyrë, që u përkasin Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Cështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme, Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, të Forcave të armatosura, të Shërbimit informative, të shtetit dhe të Policisë së Burgjeve:
 - Vërtetim nga Policia e Shtetit;
 - Vërtetim nga Garda e Republikës;
 - Vërtetim nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm;
 - Vërtetim nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit;
 - Vërtetim nga Forcat e Armatosura;
- Urdhër mbrojtje apo urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes për viktimat e dhunës në familje, lëshuar nga gjykata për viktimat e dhunës në familje.
- Vetëdeklarim nëse individi/familja i përket pakicës kombëtare rome apo egjiptjane;
- Dokument i lëshuar nga institucionet përkatëse për të miturit në konflikt me ligjin;
- Vetëdeklarim se i përket grupimit LGBTI;
- Vërtetim me certifikatë familjare se individi i përket kategorisë vajzë- nënë.

Për vërtetimin e kushteve ekonomike:

- Vërtetim i të ardhurave neto të familjes ose një deklaratë me shkrim nga aplikuesi për të ardhurat e familjes dhe burimin e tyre, të cilat duhet t'i bashkëlidhen dokumente zyrtare që e vërtetojnë atë, përfshirë vërtetimin nga punëdhënësi për pozicionin dhe pagën e aplikantit e të personave të tjerë të familjes, që janë në marrëdhënie pune;
- Vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe e Sigurimeve shoqërore për derdhjen e kontributeve për të gjithë anëtarët e e vetëpunësuar të familjes (shkarkohet në E-Albania);
- Vërtetimin nga zyra e ndihmës ekonomike e bashkisë për anëtarët e familjes, të përfshirë në programin e ndihmës ekonomike dhe të pagesës për personat me aftësi të kufizuar (sigurohet nga Bashkia);
- Vërtetimin nga drejtoria rajonale e punësimit për personat e përfshirë në programin e pagesës së papunësisë (shkarkohet në E-Albania);
- Vërtetimin nga organet e sigurimeve shoqërore për personat në pension (shkarkohet në E-Albania);


Dokumentacioni i parashikuar sigurohet nga struktura përgjegjëse për strehim vetëm nëse aplikanti depoziton deklaratën e pëlqimit sipas formatit tip, shtojca "Ç", që plotësohet bashkë me Formularin e Aplikimit pranë Zyrës me një Ndalesë.

Përgatiti

Përgjegjës i Sektorit të Asistencës Ligjore

Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore

Kristinë SHTATRI



Përgjegjës i Sektorit të Shërbimit Social

Çuka BABANI

